



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQERIA UJESJELLES KANALIZIME BERAT-KUÇOVE SHA

Nr. 12 Prot

Berat me 31.07.2023

RAPORT – LIKUIDIMI

I mbajtur sot më datën 31.07.2023 pranë Shoqërisë Ujesjellesi Berat-Kuçove sha në likuidim nga likuidatori Z.Polizoj Ikonomi. Shoqëria Ujesjellesi Berat-Kuçove sha në likuidim është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit Tirane ne date 01/07/1996, me datë themelimi 01/07/1996, me aksionarë Bashkinë Berat, zoterues i 65.32% të aksioneve të kapitalit dhe Bashkinë Kuçovë me 34.68% të aksioneve të kapitalit. Me vendimin e Asamblese te Shoqërisë nr 02, date 25.04.2023, eshte vendosur prishja e shoqërisë,likuidimi i saj dhe emerimi im si likuidator i kesaj shoqërie. Ne kushtet e mesiperme,duke qene ne kushte te plota ligjore,mora persiper detyren e likuidatorit,ku ne perfundim te punes.

KONSTATOVA:

Në përputhje me parashikimet në VKM nr. 302, datë 11.05.2022, si dhe akteve të tjera të asamblesë dhe administratorëve, shoqëria Ujesjellesi Berat-Kuçove sha ka transferuar veprimtarinë dhe të gjitha aktivet dhe detyrimet, në favor të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat sha, në datën 31.12.2022. Nga kjo datë, shoqëria nuk zhvillon më veprimtarinë e zakonshme. Si rrjedhojë, shoqëria është shpallur në likuidim nëpërmjet vendimit të asamblesë Nr. 02, date 25.04.2023.

Në këtë datë shoqëria ka hartuar bilancin e gjendjes, i cili përbën edhe bilancin në datën e çeljes së likuidimit. Sipas këtij bilanci rezulton si vijon,

Gjendjet e aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit në çelje të likuidimit.

Shoqëria Ujesjellesi Berat-Kuçove sha ne likuidim, sipas bilancit ka pasur gjendje te aktiveve afatshkurtra ne vleren **868,173,979** leke, e cila perben vleren e kontributit neto të transferuar ne Shoqërine Rajonale UK Sha Berat. Këto janë të drejta që rezultojnë si diferencë midis aktiveve dhe detyrimeve të transferuara në favor të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat sha, ku inventarët dhe aktivet afatgjata janë transferuar në datën 31.12.2022, aktivet e tjera dhe detyrimet janë transferuar në datën 01.01.2023 dhe fondet bankare në datë valutat respektive në muajin Janar 2023.

Shoqëria Ujesjellesi Berat-Kuçove sha ne fillim te likuidimit ka pasur keto keto vlera te detyrimeve dhe kapitalit:

Emërtimi	Vlera Lekë
I- Detyrime totale	0
II- Kapitali	868,173,979
Kapitali i nenshkruar	876,860,000
Primi i lidhur me kapitalin	15,775,830
Rezerva rivlerësimi	77,864,210
Rezerva te tjera	22,514,169
Humbje te pa shperndara	-124,840,230
Fitim/Humbje të periudhës	0
III- Totali I detyrimeve dhe kapitalit	868,173,979

Aktivitetet e shoqërisë nga data 01.01.2023 deri në çelje të likuidimit.

Për periudhën nga data 01.01.2023 deri në datën e shpalljes në likuidim në datën 25.04.2023 shoqëria nuk ka kryer shpenzime dhe nuk ka realizuar të ardhura. Si rrjedhojë, rezultati financiar për periudhën 01.01.2023 deri në datën e shpalljes në likuidim më 25.04.2023 është zero dhe nuk ndikon në kapitalet e veta apo detyrimet dhe aktivet e shoqërisë.

Te ardhurat	0
Shpenzimet	0
Rezultati Financiar	0

Në vijim janë ndjekur procedurat e parashikuara nga ligji dhe konkretisht si vijon.

- Eshte derguar per publikim njoftimi i pare per kreditorët shkresa nr 04 prot date 26.04.2023, publikuar ne QKB me nr 9477 prot date 02.05.2023
- Eshte derguar per publikim njoftimi i dyte per kreditorët shkresa nr 8 prot date 31.05.2023, publikuar ne QKB me nr 12455 prot date 02.06.2023.

Gjate kesaj periudhe nuk janë depozituar kerkesa apo pretendime nga kreditorë te mundshem ndaj shoqërisë.

Pasi është zbatuar afati prej 30 ditë pas publikimit të njoftimit të dytë, në datën 31.07.2023 është hartuar bilanci në mbyllje të likuidimit.

Aktivitetet e shoqërisë gjatë periudhës së likuidimit.

Gjatë periudhën nga data e çeljes së procesit të likuidimit në datën 25.04.2023 deri në datën 31.07.2023 shoqëria përsëri nuk ka kryer shpenzime dhe nuk ka realizuar të ardhura.

Te ardhurat	0
Shpenzimet	0
Rezultati Financiar	0

Si rrjedhojë, rezultati financiar për periudhën e likuidimit 25.04.2023 deri në datën e mbylljes së likuidimit më 31.07.2023 është zero dhe nuk ka ndikuar në ndryshimin e aktiveve, detyrimeve apo kapitalit ashtu siç ato paraqiteshin në çelje të likuidimit.

Gjate periudhes se likuidimit nuk janë gjeneruar detyrime të reja tatimore dhe ne perfundim te likuidimit, rezulton se shoqeria nuk ka asnje detyrim ndaj palëve te treta.

Gjatë periudhës së likuidimit nuk janë zhvilluar aktivitete apo veprime të tjera.

Gjendjet e aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit në mbyllje të likuidimit.

Pra në datën e mbylljes së likuidimit, detyrimet janë zero dhe aktivet dhe kapitali neto paraqiten në të njëjtën vlerë 868,173,979 lekë. Kapitali reflektohet në aktive në formën e të drejtave ndaj Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sha për kontributin neto të dhënë në formën e transferimit të veprimtarive, aktiveve dhe detyrimeve.

Pas prishjes së shoqërisë, të drejtat ndaj Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sha do të transferohen në favor të aksionarëve në kapital në përputhje më përqindjen e pjesëmarrjes dhe paraqitet si vijon.

Aksionari	Përqindja e pjesëmarrjes	Vlera në Lekë e të drejtave në SHRUK Berat SHA
Bashkia Berat	65.32%	567,091,243
Bashkia Kuçovë	34.68%	301,082,736
TOTAL	100.00%	868,173,979

LIKUIDATOR

POLIZOJ IKONOMI

